

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarës N. B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.2115/2014 të datës 12.09.2014, pas mbajtjes së seancës fillestare në praninë e prokurorit të shtetit në Prizren Musli Gashi dhe të akuzuarës, me datë 30.08.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara:

N. B. i ati R. dhe e ëma F. e lindur E., e lindur më datë *data e lindjes...* në fshatin J. Komuna e Prizrenit, tani me banim në Prizren rruga ... nr..., ka të kryer shkollën fillore, amvise, e ve, nënë e pesë fëmijëve, me numër personal *numri personal...*, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, e gjendjes së varfër ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 21.05.2014 në Prizren, në shtëpinë e saj familjare e cila gjendet në rrugën ..., me qëllim që ti sjell vetes pasuri të kundërligjshme si shfrytëzuese e shërbimeve komunale, përfiton nga shërbimi komunal që furnizohet përmes rrjetit përçues dhe shpërndarjes së energjisë elektrike pa autorizim të furnizuesit të autorizuar, ka shfrytëzuar energjinë elektrike me njehsor i cili pllombat shtetërore i ka të hapura dhe përsëri të mbyllura, numëruesi është i manipuluar ka gjurmë të gërvishtjes së numrave në numëror, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS – Distribucioni në Prizren, ka shkaktuar dëm material në shumë prej 294.90 €.

Kësodore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK.

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 320 të KPK i shqipton dënimin dhe atë:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që vërteton

- dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse e akuzuara nuk kryen vepër të re penale.

- dënimin me gjobë në lartësi prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro) i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse e akuzuara nuk kryen vepër të re penale.

E akuzuara obligohet të dëmtuarës KEDS – Distribucioni në Prizren, në emër të dëmit të shkaktuar të paguaj shumën në lartësi prej 294.90 €, pesëmbëdhjetë ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate, pasi që e akuzuara është e gjendjes së varfër ekonomike – është amvise, prandaj lirohet nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore sepse pagesa e tyre do të rrezikon gjendjen material të akuzuarës.

Mbikëqyrjen e dënimit me kusht do të bëjë Shërbimi Sprovues në Prizren, në pajtim me nenin 150 par.1 të LESP.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.2115/2014 të datës 12.09.2014, kundër të akuzuarës N. B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarës. E akuzuara pas kësaj deklaroi se ka kuptuar aktakuzën dhe nuk e kundërshton provat materiale.

Gjykata në seancën fillestare ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike në datë 21.05.2014, në shtëpinë e saj familjare e cila gjendet në Prizren rrugën, e akuzuara N. B. me shifër të konsumatorit 9024627 me numër të njehsorit elektrik 35029112, pas një kontrolli nga ana e zyrtarëve të KEDS – Distribucioni në Prizren, është vërtetuar se e akuzuara përfiton nga shërbimi komunal që furnizohet përmes rrjetit përçues dhe shpërndarjes së energjisë elektrike pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, e shfrytëzon energjinë elektrike me njehsor i cili pllombat shtetërore i ka të hapura dhe përsëri të mbyllura, numëruesi është i manipuluar ka gjurmë të gërvishtjes së numrave në numëror, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS – Distribucioni në Prizren, ka shkaktuar dëm material në shumë prej 294.90 €.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e akuzuarës për veprimet e përshkruara si në përshkrimin faktik të aktakuzës. Gjykata nuk ka administruar provat, pasi që nuk ka ekzistuar ndonjë provë e papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale me të cilën ngarkohet dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht. Vlen të theksohet se pranimi i fajit është mbështetur në fakte që përmban aktakuza, me ç'rast e akuzuara prej fillimit të procedurës ka qenë e njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat asnjëherë nuk i ka kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarës është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK dhe në veprimet e saj formohen të gjitha elementet e qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarën ta shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë e saj penale juridike.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunim me organet e drejtësisë, sjellja korrekte gjatë

zhvillimit të procedurës, pendimi për kryerjen e veprës penale, është e gjendjes së varfër ekonomike – është pa punë dhe mbajtëse e familjes, gjer më tani nuk ka kryer vepër penale, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoj dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së saj dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e këtilla, me bindje se është proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën e akuzuara është shpallur fajtor.

Vendimi mbi kompenzimin e dëmit të dëmtuarës është marë konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1377/2014 të datës 30.08.2017

Procesmbajtësja
Myrvete Përdibuka

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.